

DPK/DMP

03-36/2013

02

11.01.2013

Regj.nr.4094/2012.

**Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Klinë**, duke vendosur në procedurën kundërvajtjes ndaj të pandehurit **Ndue Shabanaj nga Klina**, për kundërvajtje nga neni 5.1., 6.3.,9. dhe 17 al.1.3 të Ligjit për Deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të Zyrtarë të Lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë ,e duke u mbështetur në nenet 30,123,195 dhe 198 të Ligjit mbi kundërvajtjet me datë 24.12.2012 bie këtë:

## A K T V E N D I M

**PEZULLOHET** procedura e kundërvajtjes ndaj të paraqiturit **Ndue /Nikollë/ Shabanaj** i lindur me 16.06.1953 në fshatin Krushevë e Vogël KK- Klinë, tani me banim në Klinë rruga „Hasan Prishtina „ nr.1. me profesion profesor dhe Këshilltar pran Kuvendit Komunal Klinë, i paraqitur nga Agjencia Kundër Korrupsionit për kundërvajtje nga neni 5.1., 6.3. nenit 9 dhe nenit 17. al.1. 3 të Ligjit për Deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar respektivisht për mosdeklarim të pasurisë sipas kërkesë se Agjencisë Kundër Korrupsionit **SEPSE NUK ËSHTË KRYES I KUNDËRVAJTJËS ME TË CILËN NGARKOHET** e konform nenit 198.al.2 të ligjit mbi kundërvajtje.

- shpenzimet procedurale shumë paushall 5 Euro i bartë gjykata .

Me nga një kopje të këtij aktvendimi të njoftohet parashtuesi i kërkesës kundërvajtjes dhe i paraqituri .

## A r s y e t i m

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT PRISHTINË** ka parashtuar kërkesën e kundërvajtjes nr.01-2178/12 të datës 15.06.2012 për zhvillimin e procedurës kundërvajtjes ndaj të paraqiturit **Ndue / Nikollë/ Shabanaj** për kundërvajtje nga neni 5.1.,6. 3 neni 9. dhe 17. al.1. 3. të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë te zyrtarëve te lartë publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për te gjithë personat zyrtar.

Kundër aktvendimit të kësaj Gjykate Regj.nr.4094/2012 të dt. 05.10.2012 më të cilin aktvendim ishte shpallur përgjegjës dhe dënuar i paraqituri **Ndue Shabanaj** për kundërvajtje nga nenet e Ligjit Nr 04/L-050. si që është cekur në dispozitiv ,Agjencia Kundër Korrupsionit ka parashtuar ankesë në Gjykatën e lartë për kundërvajtje të Kosovës në Prishtinë,për shkak të vendimit mbi dënim dhe në një mënyrë për ndërrim të kualifikimit të kundërvajtjes . Gjykata e lartë me aktvendimin GJL. Nr. 1216/2012 të dt. 07.11.2012 ka **abroguar** aktvendimin e kësaj Gjykate të dt .05.10.2012 dhe lënda kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje,të eliminon një varg shkelje esenciale të dispozitave të procedurës së kundërvajtjes, me rekomandime që: në plotësim procedure kjo gjykate duhet: të merr në pyetje përfaqësuesin e ushtruesit të kërkesës i cili duhet të dëshmoj se kur ka kërkuar nga i pandehuri të bëjë deklarimin e pasurisë si në vështrim të nenit 6.par. 1.3 neni 9. dhe neni 17. par 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-050 dhe cilën bazë për deklarimin e pasurisë .

Kjo Gjykate ka vepruar sipas rekomandimit (vërejtjeve) që ka dhenë Gjykata e Lartë në aktvendimin e saj lidhur me aktvendimin e Abroguar. Ushtruesi i kërkesës kundërvajtjes është marr në pyetje i cili në dëshminë e tij nder tjera deklaroj se: nga Zyrtari i lartë ka kërkuar të benë deklarin e pasurisë sipas kërkesës së AKK-së, ka propozuar që i pandehuri të shpallet përgjegjës dhe të dënohet për kundërvajtje sipas nenit 17. par 1.3 e jo si që ka vepruar Gjykata duke aplikuar nenin 17.1.1. Në pyetjen e Gjykatës përfaqësuesi i ushtruesit të kërkesës është përgjigjur: kemi kërkuar që të behët deklarimi i pasurisë sipas kërkesës se Agjencisë mirëpo,ka ndodh që kërkesa të përputhet më afatin për deklarim të rregullte vjetor 1 mars deri 31 mars. Formularët për deklarim të pasurisë ia kishte dorëzuar nëpërmes zyrtares kontaktuese të Komunës së Klinës Remzije Maloku . Dëshmitarja – zyrtarja kontaktuese pranë Kuvendit Komunal ne Klinë deklaroj se ka bërë dorëzimin e formularëve për deklarimin e pasurisë të gjithë këshilltarëve qoftë nëpërmes postës elektronike,dorëzimit drejt për drejt dhe duke ua lanë në dispozicion ne sallën ku mbahen mbledhjet e Asamblesë Komunale.

I paraqituri Ndue Shabanaj i cili është ftuar që të deklarohet edhe një herë me datë 24.12.12 lidhur më at çështje të kundërvajtjes dhe me këtë rast shtoj se nga Kryetari i Asamblesë Komunale ka kuptuar se kanë arritur formularët dhe duhet plotësuar,kamë shkuar dhe i kamë marr të zyrtarja kontaktuese i kamë plotësuar menjëherë dhe i kamë dorëzuar ne agjenci. Nuk me është thanë se ka afat të caktuar .

Gjykata i shqyrtoj dhe i vlerësoj veç e veç e në lidhmëni të përbashkët mbrojtjen e të paraqiturit, dëshminë e dëshmitares, zyrtares kontaktuese dhe dëshminë e përfaqësuesit të ushtruesit të kërkesës, duke pasur parasysh vërejtjet që janë dhenë nga Gjykata e Lartë për lëshimet (shkeljet) që janë bërë me rastin e marrjes se Aktvendimit të dt. 05.10.2012 u evituan. Është bërë konsultimi i Ligjit, neneve dhe pikave që ka propozuar parashtruesi i kërkesës së kundërvajtjes nuk kemi gjetur se ka afat të caktuar për deklarim sipas kërkesës së Agjencisë. I paraqituri më të kuptuar për nevojën e plotësimit të formularve i ka plotësuar dhe dorëzuar menjëherë. Gjykata në prezencën e të dhënave të sipër cekura ka gjetur se i paraqituri **nuk është kryes i kundërvajtjes më të cilën ngarkohet** andaj, ndaj tij e konform nenit 198.al.2. të Ligjit mbi kundërvajtjet është **PEZULLUAR** procedura kundërvajtjes .

Shpenzimet paushall të procedurës i bartë Gjykata konform nenit 110.al.2.të Ligjit mbi kundërvajtje.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

**U vendos në Gjykatën komunale për Kundërvajtje në Klinë, me datë 24.12.2012. Regj. Nr. 4094/2012.**

#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi mundë të ushtroj ankesë parashtruesi i kërkesës kundërvajtjes Gjykatës së lartë për kundërvajtje të Kosovës në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi nëpërmes kësaj gjykate.



**GJYQTARI**  
Kadri Prekaj